



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04.Nr. 111-2768 /15
Kaçanik, 23.01.2015

Në bazë të nenit 12 Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës Nr.04/L-143, Udhëzimit Administrativ 11/2011 të MASHT-it, si dhe Udhëzimit Administrativ 13/2014 –Plani Vjetor i Punës dhe Plani Zhvillimor i Ofruesve të Arsimit Formal për të Rritur, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë
të arsimit dhe aftësimit profesional klasa X në;

SHMP “FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA” në Kaçanik.

Profilat:

- Teknik i telekomunikacionit.....15 nxënës
- Teknik i informatikës.....15 nxënës
- Instalues elektrik.....10 nxënës
- Teknik i trafikut rrugor.....15 nxënës
- Instalues i ngrohjes qendrore.....10 nxënës
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit.....10 nxënës
- Automekanik.....10 nxënës
- Banka dhe sigurime.....20 nxënës
- Asistent i marketingut.....20 nxënës
- Asistent juridik.....20 nxënës

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim:

1. Dëftesat e klasëve të kryera paraprake.
2. Çertifikata e lindjes.

Pagesa për regjistrim :

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë për të rritur është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT- it Nr.11/2011.


Pagesa bëhet: Drejtoria e Arsimit, kodi 1000650120000030

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur do të jetë:

- Për regjistrim të vitit për një klasë 100 €.
- Për dhënjën e provimeve plotësuese dhe diferenciale 10 €.
- Pagesa e vijuesve në punën praktike do të bëhet varësisht nga drejtimi, në maksimum 50 €.
- Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin do t’iu nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar në Udhëzuesin Administrativ MASHT 12/2011.
- Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që paraprakisht t’iu nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.
- Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe Aftësimi me të Rritur”, janë të barasvleveshme me diplomat e arsimit të rregulltë.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregulltë (18 vjet). Ndërkaq, për të u regjistruar duhet të paraqiten te drejtoria e SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit.



Drejtori i drejtorisë:
Enver kamishi